



Datë: 25.10.2025
Numër Protokolli: 7073/2025

A.nr.1251/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1251/2025 të datës 01.07.2025 të parashtruar nga ankuesja E.M, kundër organit të punësimit: Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1251/2025, e datës 01.07.2025, e parashtruar nga ankuesja E.M.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me numër protokolli 1703, i datës 09.06.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, lidhur me përfundimin e procedurës së pranimit sipas konkursit Nr. Reference RN00017213, për pozitën e punës “Zyrtar për Buxhet dhe Financa”.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil E.M (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesja), më datë 01.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokolli 1703, të datës 09.06.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, lidhur me përfundimin e procedurës së pranimit sipas konkursit Nr. Reference RN00017213, për pozitën e punës “Zyrtar për Buxhet dhe Financa” i shpallur nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 14.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria për Komunitete dhe Kthim, ndërsa, kjo e fundit, më datë 16.07.2025, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: **Kolegji i Këshillit**) **administroi këto prova**: Ankesën me numër protokolli 4431/2025 të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me numër protokolli 1703, të datës 09.06.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim; Kopjen e ID-së së ankueses;

Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 16.07.2025; Konkursin me Nr. Reference RN00017213, për Grupin e Ekonomisë, pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Lista e aplikantëve; Njoftimi i datës 20.05.2025 për verifikim paraprak; Testin me shkrim të ankuesit; Listën e rezultatit të testit me shkrim; Formularin e vlerësimit të eses për ankueses i datës 09.06.2025; Vendimin e datës 22.05.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimi; Aplikacionin e ankueses i datës 15.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur nga faqe 1-15.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Ministria për Komunitete dhe Kthim më datë 21.03.2025, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00017213, për Grupin e Ekonomisë, pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa", klasa profesional 2, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri me datë 20.04.2025.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej tetëmbëdhjetë (18) kandidatë, ku sipas njoftimit të datës 20.05.2025 për verifikimin paraprak nëntë (9) kandidatë kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak në mesin e tyre edhe ankuesja. Në testin me shkrim kanë marr pjesë tre kandidatë përfshirë ankuesen, mirëpo, asnjëri prej kandidatëve nuk ka kaluar testin me shkrim, ndërsa, si rezultat i kësaj Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim më datë 09.06.2025 ka publikuar njoftimin me numër protokolli 1703, për përfundimin e kësaj procedure pasi që asnjë nga kandidatët nuk e ka kaluar fazën e vlerësimit të testit me shkrim.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se anëtarët e komisionit të pranimi nga komuniteti serb kanë ardhur së bashku më kandidatin serb dhe të njëjtin e kanë përcjell deri tek salla dhe të njëjtin e kanë ndihmuar dhe asistuar në përgjigjet e testit. Pretendon se vlerësimi i testit me shkrim nuk ka qenë objektiv ngase pretendon se ka punuar që së paku të kalojë këtë fazë.

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me numër reference RN00017213, për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Ekonomi (pavarësisht nga specializimi). **Kërkesat specifike:** Nuk ka. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Ndërsa, në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 9 paragrafi 1: 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkura për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj".

-Nenit 39 paragrafi 1, paragrafi 7 dhe paragrafi 9: 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë.

Për më tepër, për vendosje të drejtë dhe meritorë Kolegji mori parasysh Rregulloren Nr.15/2023 për Pranimin në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenin 9 ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim.

Referuar kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore në ndërlidhje me provat materiale deh si rrjedhojë ka konstatuar se testit me shkrim i aplikuar në procedurën e kontestuar është realizuar në mënyrë elektronike, testi ka përmbajt 25 pyetje më përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja, pra pyetjet e testit kanë qenë të përgatitura në pajtim më kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, ankuesi ka dhënë 21 përgjigje të sakta tek pyetjet më opsione duke arritur 42 pikë (çdo përgjigje e saktë e vlerësuar me nga dy pikë) ndërsa, në ese është vlerësuar me 6.4 pikë, duke arritur gjithsej 48.4 pikë, pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.

Kolegji i Këshillit, vlerëson se vlerësimi i përgjigjeve me opsjon behët nga sistemi elektronik, ndërsa vlerësimi i eses behët nga komisioni i pranimi dhe është vlerësim diskrecional. Gjegjësisht, Kolegji nga analizimi i eses së ankueses nuk verën vlerësim jo real, sepse, trajtimi i temës me titull “Paraja Publike”, do të duhej të ishte në pajtim më përcaktimet sipas nenit 2 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe për rrjedhojë pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses së anëtarët e komisionit të pranimit nga komuniteti serb kanë ardhur së bashku më kandidatin serb dhe të njëjtin e kanë përcjell deri tek salla dhe të njëjtin e kanë ndihmuar dhe asistuar në përgjigjet e testit, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky pretendim është i pa argumentuar nga pala ankuese, mbi faktin e pakontestueshëm se në testin me shkrim kanë hyrë tre (3) kandidatë, ku dy nga kandidatët kanë qenë shqiptar, ndërsa, një kandidat ka serb, dhe ky i fundit nga testi me shkrim ka marr vetëm në total 26 pikë, rrethana këto që kundra argumentojnë pretendimin e ankesës së anëtarët serbe të komisionit kanë ndihmuar apo asistuar kandidatin serb.

Andaj, duke qenë se nuk është evidentuar ndonjë shkelje ligjore e cila do të cenonte të drejtat e ankues si palë në procedurë dhe meqenëse asnjëri nga kandidatet nuk ka kaluar testin më shkrim, atëherë procedura nuk ka mundur të vazhdojë me tej, kështu që, Njësia Përgjegjëse në këtë rast Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, ka vepruar drejtë duke përfunduar procedurën e pranimit sipas konkursit Nr. Reference RN00017213, për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa", pa kandidatë fitues.

Për sa më sipër, e duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1251/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtes

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses E.M;
- Udhëheqësit të NJBNJ-së në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- Arkivit të KPMSHCK-së.